



**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE**

---

**PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 06-18 MUAJ**  
**MUAJI JANAR**



**PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS**

 Fëmijët e Tiranës

<http://femijetetiranes.al/>

 femijet\_e\_tiranes

© **Sektori i Zhvillimit dhe Kujdesit Psiko-Social**

## Kuriozitete për Muajin Janar



### Çfarë duhet të dimë për muajin Janar?

- **JANARI** është muaji i parë i vitit
- Nata është më e gjatë se dita.
- Shumë kafshë bien në gjumë të gjatë.



## Grupmosha e fëmijëve: 06-18 muaj

- ✚ **Java I: Familja, anëtarët dhe shtëpia jonë.**
- ✚ **Java II: Profesionet e mjekut, dentistit, policit dhe shitësit.**
- ✚ **Java III: Profesionet e artit: Këngëtar, piktor, muzikant dhe balerin.**
- ✚ **Java IV: Profesionet e kuzhinierit, muratorit, parukierit dhe fermerit.**




### **Tema mujore: “Familja dhe profesionet”**

<b>Temat Javore</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Koha e realizimit</b>
<b>Anëtarët e familjes:</b>	<b>Të njohim familjen dhe anëtarët e saj.</b>	<b>Java I</b>
<b>Profesionet e mjekut, dentistit, policit dhe shitësit:</b>	<b>Të ndërtojmë aktivitete njohëse ku fëmijët nëpërmjet lojës të mësojnë profesionet</b>	<b>Java II</b>
<b>Profesionet e artit: Këngëtar, piktor, muzikant dhe balerin.</b>	<b>Të njohim fëmijët me profesionet e artit duke i udhëzuar dhe nxitur të kryejnë aktivitete artistike.</b>	<b>Java III</b>
<b>Profesionet e kuzhinierit, muratorit, parukierit dhe fermerit.</b>	<b>Të kryejmë aktivitete me punë dore dhe art ku fëmijët të kenë mundësi të zhvillojnë njohjen dhe motorikën.</b>	<b>Java IV</b>


## Tema mujore: “Familja dhe profesionet”

### Tema e javës: Familja, anëtarët dhe shtëpia jonë.



Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Familja ime. 	<b>Aktivitet 1: Edukatore/ Fëmijë.</b> Edukatorja tregon dhe identifikon me gisht një vizatim të thjeshtë, ilustrim ose foton e një familje. Duke emërtuar personazhet kryesor të familjes: Mami, Babi dhe fëmijët (motër/vëlla). <b>Aktivitet 2:</b> Fëmijët mbi 12 muajsh Edukatorja ndanë në rrokje fjalët kryesore: Ma/mi dhe ba/bi si dhe identifikohen ato me gishtin tregues tek ilustrimi me figura. <b>Kënga :</b> “Familja e gishtave”.	Manuali i vjershave/këngëve  Mjete didaktike (vizatime të prera nga revista me ilustrime/ foto familjare)


<p><b>E Martë</b></p>	<p><b>Gjyshe/Gjyshi</b></p> 	<p><b>Aktivitet 1: Ilustrim dhe identifikim.</b> Edukatorja u shpjegon fëmijëve se në këtë figurë (ilustrim me figurë) duke treguar me gisht, identifikon: Gjyshin dhe gjyshen.</p> <p><b>Aktiviteti 2:</b> Emërtojmë duke ndarë në rrokje fjalët: Gjy-shi &amp; Gjy-she.</p> <p>Duke i përsëritur ato fjalë me tinguj muzikor</p> <p><b>Kënga:</b> “E Gjyshes”.</p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve</p> <p>Mjete didaktike/ Ilustrime me figura</p>
<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p><b>Rolet në familje</b></p> 	<p><b>Luajmë me role:</b> Me anë të lodrave si: kukulla bebe ose lodra arushi/lepurushi etj, improvizohet loja e zakonshme e përkujdesjes në familje si Babi-Mami-Bebi. I ilustruam fëmijëve këtë rol dhe e shoqëojmë me fjalë të plota dhe me ritëm të ngadaltë.</p> <p><b>Improvizim i sjelljes së prindërve:</b> Edukatorja tregon se si prindërit sillen kur luajnë me fëmijën dhe se si ata sillen kur fëmija qan.</p> <p><b>Aktivitetet:</b> Edukatorja i drejton një lodër bebe fëmijës dhe e mëson se si të manipulojë me të, si ta përkundi atë, që të pushojë së qari.</p> <p><b>Lojra energjike</b> me Top ngjyrë të kuqe dhe blu. Hedhim topin me këmbë dhe me dorë.</p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve</p> <p>Mjete didaktike: Kukulla bebe/arush/lepurushe etj</p>

<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Shtëpia ime</b></p> 	<p><b>Aktivitet:</b> Stafii përgatit format gjeometrike të prera më parë për të formuar shtëpinë duke përdorur ngjyrat bazë. Më pas fëmijëve të ndarë në grupe iu identifikohet disa pjesë kryesore të saj duke i treguar me gisht.</p> <p>Puna organizohet në dy grupe kryesore.</p> <p><b>Lojë:</b> Me kuba ndërtues me katër ngjyra kryesore si e kuqe, blu, e gjelbër dhe e verdhë.</p> <p><b>Këngë:</b> “Shtëpia e Bubit”.</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve.</p> <p>Mjete didaktike</p> <p>Katër formate A4 me ngjyrat bazë të kuqe, blu, të gjelbër dhe të verdhë.</p>
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Përsëritja e aktiviteteve të javës</b></p>	<p><b>Përsëritje:</b> Aktivitete të realizuara dhe të mësuara gjatë javës.</p> <p><b>Lojëra energjike me top</b> me ngjyra të theksuara.</p> <p><b>Përralla:</b> “E Gjyshes” .</p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve. Manuali i Lojrave</p> <p>Libri: Përralla e caktuar</p>



## Tema mujore: “Familja dhe profesionet”

Tema e javës: Profesionet e mjekut, dentistit, policit dhe shitësit.




Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<b>Profesioni i mjekut</b> 	<p><b>Aktivitet 1:</b> Edukatorja improvizon vizitën e një kukulle tek mjeku. Fëmijëve i'u demonstron me hapa se si realizohet kjo vizitë tek mjeku duke manipuluar me kukullën lodër.</p> <p><b>Aktiviteti 2:</b> Përsëritet aktiviteti (Fëmijët mbi 12 muajsh) Loja: Bëjmë sikur! Këtë rradhë imitojmë rolin e mjekut me bashkëpunimin e fëmijës. Përdorim setin e lodrave të mjekut.</p> <p><b>Qëllimi kryesor:</b> Nxisim të kuptuarin me veprime dhe sjelljen kundrejt kukullës që kanë para duarve të tyre.</p> <p><b>Këngë lëvizore:</b> “Nëse ti je i gëzuar”</p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve</p> <p>Mjete didaktike Seti i lodrave të mjekut</p>



<p><b>E Martë</b></p>	<p><b>Profesioni i dentistit.</b></p> 	<p><b>Aktivitet 1:</b> Edukatorja improvizon vizitën e një kukulle tek dentisti. Fëmijëve i'u demonstron me hapa se si realizohet kjo vizitë tek dentisti duke manipuluar me kukullën lodër.</p> <p><b>Aktiviteti 2:</b> Përsëritet aktiviteti (Fëmijët mbi 12 muajsh) Loja: Bëjmë sikur! Këtë rradhë imitojmë rolin e dentistit me bashkëpunimin e fëmijës. Shembull: Hapim gojën! /Aaaaa</p> <p><b>Përrallë:</b> Era shkon tek dentisti.</p>	<p>Manuali i vjershëve/këngëve.</p> <p>Përralla/bashkëngjitur programit.</p>
<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p><b>Profesioni i policit.</b></p> 	<p><b>Aktivitet 1:</b> Edukatorja improvizon ecjen brenda vijave të bardha të një kukulle lodër dhe rolin e policit (lodër me veshjen e policit). Fëmijëve iu demonstron me hapa se si polici lajmëron kur thyhet rregulli (demostrim me bilbil) .</p> <p><b>Aktiviteti 2:</b> Përsëritet aktiviteti: (Fëmijët mbi 12 muajsh) Loja: Bëjmë sikur! Këtë rradhë imitojmë rolin e policit. Shembull: Çfarë bënë polici nëse ecim jashtë vijave të bardha?/ Bie bilbilit</p> <p><b>Këngë levizore:</b> “Nëse ti je i lumtur”</p>	<p>Manuali vjershëve/këngëve</p> <p>Formate të bardha A4, Set me lodra (polici)</p>



<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Profesioni i shitësit.</b></p> 	<p><b>Aktivitet 1:</b> “ Dyqani i lodrave ”. Fëmijët e ndarë në dy grupe improvizojnë në “blerjen e disa lodrave” e krijuar në ambientin e dhomës së grupit. Rolin e shitësit dhe të blerësit e realizojnë edukatoret e grupit.</p> <p><b>Aktivitet 2:</b> Me ndihmën e edukatoreve mësojnë si mund të japin lodra, vetëm rolin e shitësit. (Fëmijët mbi 12 muajsh)</p> <p><b>Kërcejmë:</b> Këngë për fëmijë</p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve</p> <p>Mjete Didaktike : Lodra të ndryshme të kësaj grupmoshe.</p>
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Përsëritje të aktiviteteve të javës</b></p>	<p><b>Loja:</b> Bëjmë sikur !</p> <p><b>Përsërisim të gjitha profesionet:</b> Mjeku/Dentisti/Polici/Shitësi</p> <p><b>Përrallë e lirë</b></p> <p><b>Këngë lëvizore</b></p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve</p> <p>Manuali i lojërave . Libra me përralla .</p>

## Tema mujore: “Familja dhe profesionet”

**Tema e javës: Profesionet e arteve: Këngëtar, piktor, muzikant dhe balerin.**



Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
----------	---------	-------------	----------------

**E Hënë**

**Profesioni i këngëtarit**





**Aktiviteti 1:** Edukatorja këndon me mikrofon në dorë këngë të thjeshta me fjalë të plota dhe ngadalë. Ajo realizon muzikën e këngës duke imituar me zanoren la,la.



**Aktiviteti 2: Fëmijët mbi 12 muajsh**

Edukatorja përpiqet që fëmijët të imitojnë ndonjë fjalë të thjeshtë të këngës.

**Këngë:** “Qingji i vogël”

Mjete didaktike : Mikrofon lodër  
Manuali i vjershave/këngëve


<p><b>E Martë</b></p>	<p><b>Profesioni i piktorit.</b></p> 	<p><b>Aktivitet 1:</b> Edukatorja ngjyros vizatime bardhë e zi si: lule te thjeshta duke i shpjeguar ato. Sugjerohet që fëmijët të jenë të lirë të ndjekin në dy grupe të mëdha.</p> <p><b>Aktivitet 2:</b> Fëmijët mbi 12 muajsh. Edukatorja realizon mbajtjen e lapsit nga fëmija me dorën e saj. Mund të ngjyros me ngjyra tek figura e bardhë e zi .</p> <p><b>Këngë të ndryshme</b> <b>Lëvizje energjike</b> që shoqëron këngën.</p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve</p> <p>Mjete didaktike : Fletë të bardhë Formati. Pako me lapsa të trashë me ngjyrat bazë</p>
<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p><b>Profesioni i muzikantit.</b></p> 	<p><b>Aktivitet: Improvizim</b> Edukatorët udheheqin fëmijët me vegla muzikore të ndryshme të ndërtojnë orkestrën duke luajtur me këto vegla muzikore. Në këtë aktivitetit edukatorët kërcejnë me fëmijët së bashku.</p> <p><b>Përrallë e lirë</b></p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve .</p> <p>Përrallë</p>



<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Profesioni i balerinit</b></p> 	<p><b>Aktivitet i përgjithshëm:</b> Fëmijët të drejtuar nga edukatorët kryejnë lëvizje të balerinëve dhe kërcëjnë në grup së bashku nën ritmin e muzikës</p> <p><b>Këngë lëvizore 1 dhe 2</b></p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve.</p>
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Përsëritja e aktiviteteve të javës</b></p> 	<p><b>Aktivitet:</b> Improvizim “<b>Festa jonë</b>”.</p> <p>Të gjithë fëmijët të udhëhequr nga edukatorja e grupit; këndojnë, luajnë me mjete muzikore lodra dhe kërcëjnë së bashku me këngë për fëmijë në sfond.</p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve .</p>


**Tema mujore: “Familja dhe profesionet”**

**Tema e javës: “ Profesionet e shërbimit: Kuzhinieri, parukieri, muratori dhe fermeri.**



Java VI	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p><b>Profesioni i kuzhinierit</b></p> 	<p><b>Aktivitet i përgjithshëm:</b> Në grup edukatorja i tregon fëmijëve se si kuzhinierja e çerdhës përgatit ushqimin me setin e lodrave të kuzhinës.</p> <p><b>Punë dore:</b> Fëmijët formojnë me brumë topa të vegjël.</p>	<p>Manuali i lojërave Mjete Didaktike Set kuzhine .</p>

<p><b>E Martë</b></p>	<p><b>Profesioni i parukierit</b></p> 	<p><b>Aktivitet i përgjithshëm:</b> Edukatorja demonstron profesionin e parukierit duke e demonstruar me një kukëll lodër.</p> <p><b>Aktivitet:</b> Improvizim (Fëmijët mbi 12 muajsh) Edukatorja i udhëheq të krehin kukullën.</p> <p><b>Përrallë e lirë</b></p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve .</p> <p>Mjete Didaktike: Set lodrash parukieri</p>
<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p><b>Profesioni i muratorit</b></p> 	<p><b>Aktivitet 1:</b> Edukatorja demonstron me anë të mjeteve të riciklueshme si psh: kuti kartoni të vogla apo kuba të mëdhenj gome se si ndërtojmë një shtëpi.</p> <p><b>Aktivitet 2:</b> Edukatorja udhëzon fëmijët të ndërtojnë shtëpinë duke vendosur blloqet me kartona/kuba me ngjyra të theksuara.</p> <p><b>Kënga:</b> Shtëpia e Bubit</p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve .</p> <p>Mjete didaktike: Kuti kartoni, kuba gome</p>

<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Profesioni i fermerit.</b></p> 	<p><b>Aktivitet i përgjithshëm:</b> Edukatorja demonstron disa kafshë për të cilat kujdeset fermeri: I demonstron ato dhe imiton tingujt e tyre.</p> <p><b>Këngë &amp; Kërcim:</b> “Plaku Donald ka një fermë”</p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve .</p>
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Përsëritja e aktiviteteve të javës</b></p>	<p><b>Loja:</b> Bëjmë sikur!</p> <p><b>Përsërisim të gjitha profesionet:</b> Kuzhinierit/parukierit/muratorit/fermerit</p> <p><b>Këngë të ndryshme</b> <b>Lëvizje energjike</b> që shoqëron këngën.</p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve .</p> <p>Mjete Didaktike</p>